

Data 18.03.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës -Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Mirëmbajtja dhe Menaxhimi i Sheshit “Skënderbej

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pastrim i pjesëve të jashtme të ndërtesave	45452000-0
Sherbime mirembajtje dhe riparimi	50000000-5
Sherbime të mirembajtjes së pemeve	77211500-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 132,005,225.27 (njëqind e tridhjetë e dy milion e pesë mijë e dyqind e njëzet e pesë pikë njëzet e shtatë) lekë, pa TVSH.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është **1,374,481. 73** (një milion e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e tre) Euro

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 17.03.2026 është 96.04 euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Certifikatë **ISO 9001-2015** ose ekuivalent (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*), e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8), nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo certifikatë është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës është e rëndësishme realizimi me sukses i kësaj procedure dhe operatorët pjesëmarrës të provojnë se kanë një sistem të menaxhimit të cilësisë duke demonstruar aftësinë e tyre për të ofruar vazhdimisht mallra që plotësojnë dhe garantojnë kërkesat e AK-së.

2.1.2 Certifikatë **ISO 14001-2015** ose ekuivalent (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*), e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo certifikatë ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërgjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Të qenit i pranishëm në tregun lokal dhe atë global, tani po matet me respekt dhe respekt që u jepet njerëzve. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë.

Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14001 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore. Ajo është

në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me çertifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj. Ky standart tregon se kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis.

2.1.3 Çertifikatë **ISO 45001-2018** ose ekuivalent (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*), e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8), nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kriteri i vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituara, përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale dhe duhet të jetë i pajisur me certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standarde të kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për sigurinë në punë.

2.1.4 Liçencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- N.P. 7- A Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
- N.P-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- N.S 16-A Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

- **N.P. 7 A:** Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit,

funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Kjo pikë është kërkuar referuar preventivit të punimeve dhe relacionit teknik ku parashikohen punime mirëmbajtje të sistemit të kanalizimeve ku përfshihet sistemi gatik, kanalizimet e ujërave të shiut, sistemi i shatërvaneve, e puseve të ujit dhe depos së ujit.

- **N.P.12 A:** Punime të inxhinierisë mjedisore konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Kjo pikë është vendosur referuar preventivit të punimeve dhe relacionit teknik ku parashikohen punime komplekse mirëmbajtje të gjelbërimit pasi kemi të bëjmë me sipërfaqe të gjelbëruar prej rreth 13.800 m², ku përfshihet bimësi me një ndërtim shtresor dhe përbërje të shumëllojshme. Janë më shumë se 150 specie të pemëve, shkurreve, luleve, hardhi, zhardhok një/ dy vjetore dhe një shtresim vertikal është aplikuar ku pemët përbëjnë shtresën kryesore që strehon nënshtresat që përbëhen nga shkurre dhe bimë të ulta shumëvjeçare. Përdorimi i llojeve gjetherënëse dhe gjelbërim gjithëvjetor në pemë, shkurre dhe shtresa bimësh të ulta shumëvjeçare siguron një pamje të gjelbër gjatë gjithë vitit që përbën një ekosistem të mirëfilltë.
- **N.S.- 16 A** Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij. Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujit të pijshëm të ujërave që duhen pastruar, përfshirë edhe grumbullimin e biogazit dhe të prodhimit të energjisë elektrike e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

Kjo pikë është vendosur referuar preventivit të punimeve dhe relacionit teknik, ku parashikohet mirëmbajtja e depos së ujit, përfshirë pastrimin dhe klorifikimin e saj.

2.1.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e kontratës si mëposhtë vijon:

- Liçensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullimin dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme , me kod III.2.B .
- Liçensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për shërbime ndërhyrese higjeno-shëndetësore, me kod II.8.B
- Liçensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtarine e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis, me kod III.2.A.
- Liçensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për prodhim dhe tregtim te produkteve te mbrojtjes se bimeve, me kod II.5.A.3

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe kërkesat e ligjit Nr. 10463 , datë 22.09.2011“Për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve“, i ndryshuar , Ligjit 10 081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 538, datë 26.5.2009 „Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga /apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta“.

- Liçenca për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane, me kod III.2.B është kërkuar referuar preventivit të punimeve dhe relacionit teknik, ku përfshihet pastrimi i sheshit, shkarkimi i koshave të mbeturinave si dhe koshave të tualeteve, të cilat konsiderohen mbetje urbane siç janë mbetje amballazhi plastike, mbetje amballazhi metalike, letër e karton, qelq, plastik, mbetjet nga pastrimi i rrugëve etj. Subjekti i pajisur me këtë liçensë ka të drejtë të bëjë grumbullimin, transportimin dhe largimin e tyre.
- Liçenca për shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore me kod II.8.B është kërkuar referuar preventivit të punimeve dhe relacionit teknik ku përfshihet nevoja për marrjen e masave dhe kryerjen e shërbimit të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të ambjenteve të brendshme të parkimit nëntokësor duke përfshirë edhe tualetet e këtij parkimi.
- Liçenca për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis, me kod III.2.A është kërkuar në zbatim të Ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrotjen e mjedisit”, Ligjit Nr. 8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, referuar preventivit të punimeve dhe relacionit teknik, ku përfshihen pastrime të ndryshme, edhe me solucione, të ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, pastrimi i sistemit të kanalizimeve, mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara me qëllim vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të punimeve që kërkohen të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis nëpërmjet identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit në mënyrën e duhur të ndikimit në mjedis të një veprimtarie, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujë, ajër, klimë, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.
- Liçensa për prodhim dhe tregëtim të produkteve të mbrojtjes së bimëve, me kod II.5.A.3 janë kërkuar referuar preventivit të punimeve dhe relacionit teknik, ku përfshihet mirëmbajtja e gjelberimit, e cila konstiston, midis të tjerave, në zëvendësimin e shkurreve dhe të bimëve shumëvjeçare, trajtimin me kimikate ushqyese për bimësinë e shumëllojshme si dhe trajtimin ekologjik kundër insekteve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 2, gërma b) dhe vlerën e xhiros minimale vjetore e ka përcaktuar brenda kufirit maksimal të lejuar nga ky nen.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022,2023,2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor, sipas ekstraktit të regjistrimit, për vitin 2025 e keqet e maturuara për vitin 2026. Vërtetimi duhet detyrimisht të jetë përshkruar, ndër të tjera, edhe NIPT-in e subjektit. Në të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument në momentin e dorëzimit të dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrorjnë aktivitetin, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 "Për QKB" i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 "Për QKR", i ndryshuar.

Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimeve në objekt dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm.

- i. Kontratë pune të vlefshme
- ii. Diplomë
- iii. Të figurojë në listëpagesat operatorit ekonomik pjesëmarrës për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti

Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person përgjegjës (drejtues teknik) për ndjekjen e shërbimeve, i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve, pasi është përgjegjës për kryerjen e shërbimeve, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Staf i teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kerkohen të realizohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit. Gjithashtu kërkesa për Drejtuesin Teknik, si personel kryesor për zbatimin dhe ndjekjen e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën, rëndësinë si dhe kohëzgjatjen e saj dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën **60 (gjashtëdhjetë) personave**, për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b) Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kerkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i punetoreve është përllogaritur në proporcion të drejtë me volumet e zërave të preventivit të punimeve, pasqyruar në analizën e çmimeve duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën, rëndësinë dhe kohëzgjatjen e saj, që i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet e ofertuesve me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Konkretisht, numri i punetoreve është përllogaritur bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës sipas analizës së çmimeve, pjese e dosjes së prokurimit. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i

punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Vendosija e kriterit për një punësim te paktën 60 persona është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomën përkatëse si mëposhtë:

- 2 (një) Agronom
- 1 (një) Inxhinier Mjedis (te jete i pajisur me certifikat leshuar nga Min.Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)
- 1 (një) Inxhinier Ndërtim
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteret për stafin drejtues teknik dhe atë mbështetës lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Kërkesa për stafin inxhinierik dhe profili i tyre, si personel kryesor për zbatimin e kontratës është vendosur duke marrë në konsideratë zërat e punimeve sipas preventivit dhe relacionit teknik, vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën, rëndësinë si dhe kohëzgjatjen e saj. Kjo kërkesë i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Konkretisht, referuar preventivit dhe raportit të studimit argumentojmë nevojën e inxhinierëve si mëposhtë vijon:

- Agronomi i nevojshëm për mbarëvajtjen e punimeve në funksion të mirëmbajtjes së gjelbërimit
- Inxhinier Mekanik i nevojshëm për mbarëvajtjen e punimeve në funksion të mirëmbajtjes së puseve të ujit, së dhomes teknike dhe mobilimit urban.

- Inxhinier Hidroteknik i nevojshëm për mbarëvajtjen e punimeve në funksion të mirëmbajtjes së sistemit të kanalizimeve, sistemit të shatërvaneve, puseve të ujit, të depos së ujit dhe të dhomes teknike.
- Inxhinier Elektrik i nevojshëm për mbarëvajtjen e punimeve në funksion të mirëmbajtjes së sistemit të ndriçimit dhe të dhomes teknike.
- Inxhinieri i Mjedisit është kërkuar si ekspert, i cili do të monitorojë të gjithë veprimtarinë mjedisore, bazuar në zërat e punimeve të preventivit dhe relacionin teknik. Duke pasur në konsideratë vendodhjen e sheshit, ku ka një fluks të madh popullate kërkohet ti jepet vëmendje dhe rëndësi e veçantë monitorimit të shërbimeve, që gjenerojnë mbetje dhe raportimeve për marrjen e masave nga eksperti .
- Inxhinieri i ndertimit është kërkuar në përputhje me kërkesat për mirëmbajtje të sheshit, i cili në pjesën më të madhe është i shtruar me pllakë dhe asfalt dhe asistencë e inxhinierit është e nevojshme për mirëmbajtjen e tij.

2.3.5 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si: 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa, "Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

- "Përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë": Roli i përgjegjesit është mbikëqyrja dhe zbatimi i masave të sigurisë në punë për të mbrojtur shëndetin e punonjësve. Ai ka një përgjegjësi më të përgjithshme dhe mbikëqyrëse për të siguruar që të gjitha rregullat dhe standardet e sigurisë po respektohen. Përfshihen inspektime të rregullta, vlerësime të rrezikut dhe zbatimin e masave parandaluese . Përgjegjesi raporton mbi çështjet e sigurisë dhe sigurohet që ka trajnime të vazhdueshme për të gjithë stafin.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

- 3 (tre) hidraulik
- 2 (dy) saldator
- 3 (tre) elektrikist
- 2 (dy) karpentier
- 2 (dy) pllakashtrues

- 7 (shtate) punonjës të trajnuar për ” punime në sipërfaqe gjelberta”
- 2 (dy) shofer
- 2 (dy) manovrator
- 2 (dy) punonjes per punime ne lartesi
- 5 (pese) punetore per Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: kontratën individuale të punës te vlefshme; diplomën e shkolles/deshmi nga organe/institute te akredituar që të vërtetojë kualifikimin profesional të punonjesve te mësipërm sipas ligjit Nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne Republikën Shqipërise.

Operatori ekonomik te paraqese deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sa më sipër sipas formatit te meposhtem:

Tab 1

Emer Mbiemer i punonjesit dhe nr identifikimi publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Profesioni	Institucioni
Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)		

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT si dhe me plotësimin e formatit të deklarates sipas Tab 1.

Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Kriteret për stafin mbështetës të kualifikuar lidhen ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Kërkesa për kete staf është vendosur duke marrë në konsideratë zërat e punimeve sipas preventivit dhe relacionit teknik, vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën, rëndësinë si dhe kohëzgjatjen e saj.Kjo kërkesë i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat :

- a) Çertifikate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim per nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të matrialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) ose Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që

duhet të jetë i pajisur me Certificate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim per nxjerrjen dhe leshimin e etiketave te furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certificate origjine te leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 per percaktimin e kriterëve te tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative)

Ose

- b) Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim prodhuesi/distributori per furnizimin nga subjekti importues ku duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij, shoqëruar me një deklaratë (nga subjekti importues) qe ne momentin e furnizimit me druret dhe shkurret dekorative (sipas sasise dhe specifikimeve teknike) do shoqerohen me “ Certificate Fitosanitare “ nga shteti importues , e cila verteton pastertine gjenetike bimes .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Ligjin nr.10416, datë 07.04.2011 ” Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, dhe VKM nr. 523, datë 13.07.2016 ”Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”. Te dhënat për certifikatat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe bazuar në aktin nënligjor normativ të nxjerrë në bazë të Ligjit 10416, ku në pikën II,”KËRKESAT PËR TREGTIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE FIDANËVE”, gërma ”d” të VKM 523 përcaktohet se: ”1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse: d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi”.

2.3.8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot per thithjen e ujerave zeza (sonde)	1 copë	Pronësi ose me qera
Makinë teknologjike e vogël për fshirjen e rrugëve .	1 copë	Pronësi ose me qera
Automjet vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Platformë ngritëse (shkallë) ose autovinç me kosh per punime ne lartesi min10-15 m	2 copë	Pronësi ose me qera
Makineri dizifektimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per shkulje pemesh ekzistuese	1 copë	Pronësi ose me qera
Mjet per korrijen e barit professional me kapacitet koshi minimumi 800 litra .	2 copë	Pronësi ose me qera

Makineri përpunim guri	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri speciale për fshirjen e pllakave të gurit	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë speciale për pastrim me rërë për monumentet	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri për hidrombjelljen e barit	1 copë	Pronësi ose me qera
Motosharrë dore për krasitje bimesie e ulet	2 copë	Pronësi ose me qera
Motosharre me krah për krasitje pemesh në lartësi	1 copë	Pronësi ose me qera
Aspirator për pastrim gjethesh	1 copë	Pronësi ose me qera
Ventuse (kapeze) pllakash	1 copë	Pronësi ose me qera
Kangjella rrethimi	200 m ²	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si mëposhtë:

- Kokore minimumi 60 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 5 copë
- Uniforma për punonjësit , minimum 60 copë

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jepen aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike dhe analizës së çmimeve, pjesë e dosjes së prokurimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të

pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike sipas Studimit të Fizibilitetit për Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e sheshit “Skënderbej”, i cili është hartuar nga studio “iRI” sh.p.k e “Hydro&Energy” sh.p.k dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik Nr.3, datë 20.02.2019, Bashkia Tiranë, bashkëlidhur DST-së.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT